



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

VLORË

Nr.809 Akti  
Datë 18.03.2016

Nr.618 Vendimi  
Datë 25.04.2016

**V E N D I M**  
**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

**GJYQTARE: Gentiana XHELILI**

Gjykata Administrative Shkalla e Parë Vlorë, e përbërë nga:

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 25.04.2016 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr.809 Akti, që u përket palëve:

**PADITËS:** Subjekti Person Fizik "Antuela Pashaj", me nr-L46320202D NUIS, identifikuar nga gjykata me kartën e identitetit me nr-I26017073T, me adresë në lagjen "Isa Buletini" Vlorë, përfaqësuar në gjykim me deklaram në seancë gjyqësore nga Lavderim Pashaj, identifikuar nga gjykata me kartën e identitetit me nr-E80505121L.

**E PADITUR:1-** Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me nr.4590 prot datë 11.04.2016 nga Dorian Demiraj dhe nga juristja Orjada Myrtja me autorizimin me nr. 5171 prot, date 25.04.2016.

**Avokati i Paditës: Avokatarës e Titetit Zyrtar Vlorë, (në marrëveshje):**

**OBJEKTI:** Konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ "Njoftim Vleresimi Per Detyrimet date 14.10.2015" per vleren e gjobave ne shumen 255.000 (dyqind e pesedhjetë e pese mijë) leke, i leshuar per paditesen subjektin Person Fizik "Antuela Pashaj", me nr L46320202D NUIS nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore.

**BAZALIGJORE:** Nenet 31, 32, 154 e vijues te Kodit Procedures Civile, Nenet 45 e vijues te Ligjit Nr.9920 date 19/05/2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Nenet 2, 66, 80, 81, 105, 106, 115/b, 118, 121, 124 i Kodit Procedures Administrative, Ligji Nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ( i ndryshuar), pika 45 e udhezimit te Ministrit te Financave me Nr.24 date 02/09/2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", Ligji Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimi mosmarreveshje administrative".

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore, degjoi përfaqesuesin e pales paditëse subjekti person fizik "Antuela Pashaj". Z. Lavderim Pashaj i cili kërkoi nga gjykata pranimin e kërkesë padisë, dëgjoi palën e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë përfaqësueses e saj Znj.Orjada Myrtaj e cila kërkoi nga gjykata rrëzimin e kërkesë padisë, pala pjesëmarrëse në gjykim Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua në konkluzione përfundimtare dhe nuk rezultoi që të ketë paraqitur prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate në lidhje me këtë gjykim, pasi ka vijuar gjykimi në mungesë të saj me gjithë njoftimin e rregullt që ka pasur për procesin gjyqësor dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N**

Se pala paditëse subjekti person fizik "Antuela Pashaj" i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë padinë me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesë padisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Në bazë të nenit 7 dhe 12 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", gjykimi u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtarë.

Gjykata kryesisht bazuar në nenin 125 dhe 193 të K.Pr.Civile vendosi të therrase në gjykim përfaqesuesin e interesave të shtetit Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlore.

Fillimisht padia është paraqitur nga paditesja me emrin Ela Pashaj dhe në seancën e veprimeve përgatitore të datës 11.04.2016, paditesja ka kërkuar të saktësohet emri i saj bazuar në të dhënat e kartës së identitetit dhe gjykata bazuar në nenin 125 dhe 154/a të K.Pr.Civile vendosi të saktësojë identitetin e pales paditëse nga emri Ela Pashaj në Antuela Pashaj.

### **Rrethanat e faktit:**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse subjekti person fizik "Antuela Pashaj" është e pajisur me nr-L46320202D NUIS, e cila ushtron aktivitetin e saj "fast-food, etj" me adresë në lagje "28 Nëntori" Vlorë.

Rezulton se paditësja aktivitetin e saj "fast-food", e ka ushtruar në një dyqan të marrë me qera nga shtetasi Nikolin Murataj në muajin Janar 2014 deri në datë 02.06.2015 kur e ka dorëzuar dyqanin e marrë me qera, fakt i cili rezultoi nga deklarata noteriale me nr.451rep, nr.192/1 kol datë 04.03.2016.

Rezulton se paditësja në datë 02.06.2016 ka aplikuar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Dega Vlorë për tu çregjistruar si subjekti tregtarë e cila disponon nr-L46320202D NUIS.

Rezulton se në datë 28.08.2015 nga Qendra e Regjistrimit Vlorë është marre vendimi për refuzimin e gregjistrimit pasi paditësja ka detyrime të pashlyera/gjobe ndaj organeve tatimore në vlerën 701 leke dhe se bazuar në nenin 45 të ligjit nr.9920 datë 19/05/2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), nuk mund të behet gregjistrimi i subjektit pa u paguar ky detyrim, të cilin paditësja e ka paguar sapo ka ardhur në dijeni në muajin Tetor 2015.

Rezulton se nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë në datë 17.09.2015 është ushtruar kontroll në ambientin që paditësja ka pasur me qera dhe të pretendon se e ka dorëzuar në datë 02.06.2015 dhe ku në perfundim të kontrollit është mbajtur akt konstatimin me nr.0564281 serie datë 17.09.2015 dhe ku rezulton se *"në lokalin fast-food, me tatim pagues Antuela Pashaj, me nr-L46320202D lagja "28 Nentori", e perfaqesuar nga Sonila Dredha e cila nuk ka karte identiteti është ushtruar kontroll ku ka rezultuar se, subjekti nuk është i pajisur me kase fiskale, në punë u gjende Sonila Dredha dhe Bilbil Fezaj të cilët nuk kanë karte identiteti të cilët do të verifikohen nëse janë siguruar apo jo pranë organit tatimor, nuk ka të afishuar cmimet, ambienti që ushtron aktivitet është me qera"*.

Në vijim të procedurës nga pala e paditur është nxjerre njoftim vleresimi për detyrime tatimore datë 14.10.2015 i cili e ngarkon paditesen person fizik "Antuela Pashaj" me gjoba për sigurimet shoqërore 100.000 (njqind mijë) leke, si dhe gjoba inspektori në totale 155.000 (njqind e pesëdhjetë e pesë mijë) leke.

Pala paditëse me anë të kërkesë padisë drejtuar gjykatës pretendon se objektin e marrë me qira e ka dorëzuar që në datë 02.06.2015 dhe ku ka aplikuar për të gregjistruar si subjekt tatimore dhe se shtetasit e gjendur në lokalin që ajo ka pasur me qera Sonila Dredha dhe Bilbil Fezaj, paditësja nuk i njeh dhe nuk ka kurrfarë lidhje, ku për këtë qëllim i ka paraqitur gjykatës çertifikatën të përbërjes familjare të saj datë 17.03.2016 lëshuar nga Zyra Gjendjes Civile Vlorë.

**Pala paditëse person fizik "Antuela Pashaj" duke mos qenë dakort me masën administrative të marrë nga pala e paditur i është drejtuar me kërkesë padi gjykatës duke pretenduar se;**

**Së pari;** rezulton e provuar se paditesja Antuela Pashaj është regjistruar si subjekt fizik me nr. L46320202D NUIS dhe ku ushtron veprimtarinë fast-food në lagjen "28 Nentori" në Vlorë, aktivitet të cilin e ka ushtruar deri në datë 31.05.2015.

Në datë 02.06.2015 paditesja ka aplikuar pranë Qendres së Regjistrimit Vlorë për të gregjistrim si person fizik pasi aktiviteti i saj tregtar nuk ishte i sukseshëm.

Gjithëseshtu rezulton se ambientin ku ushtronte aktivitetin tregtar fast-food paditesja e kishte marrë me qera, fakt i cili rezulton i provuar nga deklaratat noteriale me nr.451 rep, nr.192/1 kol datë 04.03.2016 e lëshuar nga Nikolin Murataj pronar i ambientit të marrë me qera nga paditesja, i cili deklaroi se dyqani është lëshuar prej tij me qera tek shtetasja Antuela Pashaj, që nga muaji Janar 2014 deri në datë 02.06.2015 dhe se qeramarrësja

i ka shlyer te gjitha detyrimet, per energji, uji te pijshem dhe se prej dates 02.06.2015 dyqani ka qene i mbyllur.

Ne date 28.08.2015 nga Qendra e Regjistrimit Vlore eshte marre vendimi per refuzimin e cregjistrimit pasi paditesja ka detyrime te pashlyera/ gjobe ndaj organeve tatimore ne vleren 701 leke dhe se bazuar ne nenin 45 te ligjit nr.9920 date 19/05/2008 "*Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise*" (i ndryshuar), nuk mund te behet cregjistrimi i subjektit pa u paguar ky detyrim.

Ne lidhje me kete vendim paditesja ka ardhur ne dijeni ne fillim te muajit Tetor dhe ku menjehere e ka shlyer detyrimin prej 701 lekesh.

Nga inspektoret e Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore ne date 17.09.2015 eshte ushtruar kontroll ne ambientin qe paditesja ka pasur me qera dhe te cilin e kishte dorezuar qe ne date 02.06.2015 dhe ku ne perfundim kane mbajtur akt konstatimin me nr 0564281 serie date 17.09.2015 dhe ku rezulton se ne lokalin fast-food , me tatim pagues Antuela pashaj, me nr L46320202D lagja "28 Nentori", eshte gjetur shtetasja Sonila Dredha dhe Bilbil Fejazaj te cilet nuk kane karte identiteti te cilet do te verifikohen nese jane siguruar apo jo prane organit tatimor, nuk ka te afishuar cmimet, ambienti qe ushtron aktivitet eshte me qera.

Ne vijim te procedures nga pala e paditur eshte nxjerre njoftim vleresimi per detyrime date 14.10.2015 i cili e ngarkon paditese padrejtesisht me gjoba per sigurimet shoqerore 100.000 (njqind mije) leke , si dhe gjoba inspektori ne totale 155.000 (njqind e pesedhjetë e pese mije) leke.

Ne lidhje me keto detyrime te cilat i jane vendosur paditeses ne kundërshtim flagrant me ligjin ku thekson se paditesja as nuk i njeh fare shtetasit Sonila Dredha dhe Bilbil Fejazaj qe jane pershkruar ne aktin e konstatimit te dates 17.09.2015 nga inspektoret tatimor dhe ku prej tyre gjithashtu nuk eshte bere verifikimi i ketyre shtetasve me karte identiteti ne menyre qe te behej lidhja me paditesen qe ndaj tyre ishte punedhenese apo e afermja e tyre.

Nga prova qe i paraqet gjykates certifikate familjare rezulton se paditesja nuk ka kurr fare lidhje me keta shtetas dhe ku siç eshte permendur edhe me larte lokali eshte dorezuar qe ne date 02.06.2015.

**Së dyti;** të gjitha detyrimet e përshkruar në njoftim vlerësimin të datës 14.10.2015 ndaj paditëses janë marrë në kundërshtim flagrantë me ligjin dhe konkretisht me dispozitat si më poshtë;

Neni 48 Ligji Nr.9723, datë 3.5.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*" (i ndryshuar) "*Çregjistrimi i subjektit*" ku parashikohet se;

1. Subjektet cregjistrohen nga regjistri tregtar në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për prishjen dhe pavlefshmërinë e personave juridikë, shpërndarjen e shoqërisë së thjeshtë, në rastet e përfundimit të ushtrimit të veprimtarisë të personit fizik, si dhe në çdo rast tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi; 2. Çregjistrimi bëhet: a) në mënyrë vullnetare nga subjekti; b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë; c) sipas parashikimit të ligjeve të posaçme.

Neni 49 i Ligji Nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ( i ndryshuar) "Çregjistrimi vullnetar " ku parashikohet se ;

1. Për personat fizikë dhe për subjektet e tjera, në rastet kur ligji nuk parashikon procedura likuidimi në lidhje me to, çregjistrimi në mënyrë vullnetare kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim. Çregjistrimi në mënyrë vullnetare për personat juridikë, degët dhe zyrat përfaqësimit të shoqërive të huaja për shoqëritë e thjeshta dhe për subjektet e tjera, për të cilat ligji parashikon procedura likuidimi.

2. kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim dhe depozitimit të akteve përkatëse, që vërtetojnë kryerjen dhe mbylljen e procedurave të likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi. Çregjistrimi nuk kryhet nëse aktet e ndërmjetme të procesit të likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi, nuk janë njoftuar dhe depozituar pranë regjistrit tregtar. Këto akte depozitohen në formën e kërkuar nga ky ligj dhe/ose nga dispozita të tjera ligjore në fuqi.

Neni 45 i Ligjit Nr.9920 datë 19/05/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" ( i ndryshuar), për " Çregjistrimi i subjekteve tatimore" ku parashikohet se ; 8.Pasi tatimpaguesi ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes dhe ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, gjobat dhe interesat e papaguar, organi tatimor kompetent detyrohet të tërheqë menjëherë kundërshtimin për çregjistrim dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit.

**Së treti;** Pavlefshmëria absolute e një akti administrativ është parashikuar në nenin 116 të K.Pr.Administrative sipas të cilit ' Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme në kuptimin e këtij Kodi në rastet e mëposhtme;

a)kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;

b)kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;

**c)akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.**

Pra për sa më sipër akti administrativ "Njoftim Vlerësimi Për Detyrimet datë 14.10.2015" i nxjerrë nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë është një akt i nxjerrë në kundërshtim flagrantë me ligjin dhe ku paditësja kërkon nga gjykat konstatimin si abosulitsht të pavlefshëm të tij.

Gjithashtu paditësja në zbatim të ligjit ka ushtruar ankim administrativ ndaj njoftim vlerësimi për detyrime datë 14.10.2015 në Drejtorinë e Apelimit Tiranë ku deri më sot që po i drejtohet gjykatës ajo nuk ka marrë asnjë përgjigje nëse është marr apo jo në shqyrtim ky ankim dhe ku për këtë arsye po i drejtohet gjykatës me këtë kërkesë padi referuar nenit 32 të Kodit Procedurës Civile duke pasur një interes të ligjshëm, aktual e të drejtpërdrejtë dhe ku për rrjedhojë ka legjitimitet aktiv për ngritjen e kësaj padie si dhe pala e paditur e cila ka legjitimitet pasiv, për të kërkuar nga Gjykata Administrative Shkallës parë Vlorë pranimin e padisë.

Për sa më sipër paditësi subjekti person fizik "Antuela Pashaj" kërkoj nga gjykata pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, me anë të përfaqësuesit të saj ka kërkuar rrezimin e kerkese-padise duke prapësuar në këtë gjykim se:

**Së pari:** Ne baze të Urdhër Sherbimit me Nr.61156 Prot, Dt. 17.09.2015, inspektorët e sektorit të Verifikimit në Terren pranë DRT Vlorë, kanë ushtruar një kontroll në ambientet e subjektit "Antuela Pashaj" me Nipt L46320202D. Nga pikpamja ligjore kontrolli proceduralisht është i mbështetur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar. Pra nga ana procedurale Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë legjitimohet plotësisht në kontrollin e ushtruar në subjektin "Antuela Pashaj". Në mënyrë të përmbledhur po paraqesin pretendimet e pales paditese se: ka aplikuar për regjistrim në QKR datë 02.06.2015 si person fizik pasi aktiviteti i saj tregëtar nuk ishte i sukseshëm, por kërkesa e saj është refuzuar nga ana e QKR Vlorë datë 28.08.2015 pasi paditesja ka detyrime të pashlyera/ gjore ndaj organeve tatimore në vlerën 701 leke dhe bazuar në nenin 45 të ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar, nuk mund të bëhet regjistrim i subjektit pa paguar detyrimin".

Mbi bazën e kontrollit të ushtruar në shoqërin "Antuela Pashaj" është mbajtur Akt-Konstatimi me nr. serial 0564281 datë 17.09.2015 kurezultoi se: "...subjekti është i regjistruar në QKR, subjekti nuk ka të instaluar pajisjen fiskale, nuk ka të afishuar listen e emimeve, nuk ka të afishuar posterin informues për tërheqjen e kuponit tatimor, nuk leshon deftesë tatimore për të pasqyruar qarkullimin e realizuar të xhiros dhe ku në momentin e kontrollit në punë u gjetën këta punonjës: 1-Bilbil Fejzaj; 2-Znj. Sonila Dredha.

Subjekti është penalizuar me gjore në vlerën 255.000 leke, për keto penalitete subjekti është njoftuar me anë të aktit administrativ njoftim vleresimi nr. prot, datë 14.10.2015.

Akt konstatimi i mbajtur nga inspektorët është përcjell për procedurë të metejshme në DRT Vlorë, inspektori i dosjes ka bërë verifikimet e nevojshme dhe në bazë të konstatimit të mbajtur janë mbajtur:

Proces-Verbal Gjore me nr. serial, 0187797 datë 12.10.2015, ku në bazë të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) neni 122, pika 1 germa (a,i), subjekti është penalizuar me gjore në masën 50.000 leke për mospajisje me kase fiskale.

Nga sa mësipër mund të themi se, mospajisja me kase për qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, përben shkelje tatimore administrative dhe penalizohet me gjore në zbatim të nenit 122 të Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar), sipas të cilit citojme: neni 122, pika 1.a,i: Neni 122 Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për leshimin e kuponave.

**Së dyti;** fiskale e të biletave "1, Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregëtar, denohet në rast se: a) nuk instalon pajisjen fiskale ose sisteme të monitorimit të qarkullimit: i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale ose sistemeve të monitorimit të qarkullimit, me gjore në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) leke".

Nga sa mësipër lidhur me detyrimin për të instaluar dhe përdorur pajisjet fiskale, referuar Ligjit 9920 datë 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar, Neni 54 Kuponit tatimor 3. Të gjithë tatimpaguesit e

shitjeve me pakice, qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne mjedise apo njesi te perhershme, te hapura per publikun, duhet te instalojne pajisje fiskale dhe te leshojne kupona tatimore per cdo transaksion.

Në neni 55 "Detyrimi per perdorimin e pajisjeve fiskale", thekson: I .Tatimpaguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te fusin dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponit tatimor.

Ne Udhezimin nr. 24 date 02.09.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar Kreu VI pika 55, thuhet se: "Personat e tatueshem, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbi fitimin dhe personat e tatueshem, subjekte te takses vendore mbi biznesin e vogel dhe tatimit mbi te ardhurat, jane te detyruar te pajisen, te perdorin dhe mirembajne pajisjet fiskale ne perputhje me dispozitat e Vendimit te KM nr. V.K.M nr.781, dt. 14.11.2007 "Per karakteristikat teknike e funksionale te pajisjeve fiskale, sistemit te integruar te kompjuterizuar per transferimet periodike, automatike te deklarimeve financiare, sistemit te komunikimit per proceduren e dokumentacionin per miratimin e tyre dhe per kriteret per pajisjen me autorizim te shoqerive te autorizuar per ofrimin e pajisjeve fiskale..."

VKM nr. 781, dt. 14.11.2007, ndryshuar me VKM nr. 1476 date 12.11.2008, ndryshuar me VKM nr. 1286 date 23.12.2009, ne piken 15 ne lidhje me regjistrimin e qarkullimit, percakton se: " Te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakice, qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne mjedise, apo njesi te perhershme te hapura per publikun, instalojne pajisje fiskale dhe leshojne kupone tatimore per cdo transaksion".

**Së treti:** Ne baze te akt konstatimit te siperpermendur eshte mbajtur Proees-Verbal Gjore me nr. serial, 0187502 date 12.10.2015, ku ne baze te Ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise"(i ndryshuar), Neni 130, subjekti eshte penalizuar me gjore ne masen 35.000 leke per mosafishim te listes se cmimeve te shitjes se mallrave apo sherbimeve. Sa mesiper, mund te themi se mosafishimi i listes se cmimeve te shitjes se mallrave apo sherbimeve perben shkelje tatimore administrative dhe penalizohet me gjore ne zbatim te nenit 130 te Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", (i ndryshuar), sipas te cilit citojme: "Mosafishimi i cmimeve te shitjes se mallrave apo sherbimeve denohet me gjore me 35 000 leke, per tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogel dhe 65 000 leke per tatimpaguesit e tjere". Bazuar dhe ne nenin 59 te Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", (i ndryshuar), pika 2. "...tatimpaguesi, ne perputhje me legjislacionin tatimor, duhet te reklamoje ne vende te dukshme, fminet e mallrave dhe te sherbimeve qe ofron".

Si dhe ne Udhezimin MF, dale ne zbatim te ke tij ligji perkatesisht pika 59.2 Afishimi i cmimeve 59.2.1 "Personat e tatueshem qe shesin mallra apo sherbime me pakice jane te detyruar te afishojne ne menyre te dukshme me etikete, gminin e cdo malli apo sherbimi qe ata ofrojne".Se treti: Ne baze te akt konstatimit te siperpermendur eshte mbajtur Proces-Verbal Gjore me nr. serial, 0187501 date 12.10.2015, ku ne baze te Ligjit 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise"(i ndryshuar), Neni 122

pika 1, germa b.i, subjekti është penalizuar me gjobe në masën 50.000,(pesedhjetë mijë) leke për mos leshim deftese tatimore për të pasqyruar qarkullimin e realizuar të mallrave apo shërbimeve.

Sa me sipër, mos leshim deftese tatimore për të pasqyruar qarkullimin e realizuar të mallrave apo shërbimeve, përben shkelje tatimore administrative dhe penalizohet me gjobe në zbatim të Neni 122 pika 1, germa b.i, të Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar), sipas të cilit citojmë: "1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, denohet në rast se: b) nuk leshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve: i) për gdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobe në masën 200 000 (dyqind mijë) leke për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbifitimin, dhe gjobe, në masën 50 000 (pesedhjetë mijë) leke për tatimpaguesit e tjerë; ". Në udhëzimin e MF dale në zbatim të këtij ligji është percaktuar se: "46.1.6 Deftesa tatimore leshohet nga të gjithë personat e tatueshëm shites me pakice, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbifitimin, të cilët nuk janë të pajisur me arke regjistruese ose qe, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 781, datë 14.11.2007, në rast të veqanta mund të mos leshojnë kupon tatimor ".

**Së katërti:** Në bazë të akt konstatimit të sipërpermendur është mbajtur Proces-Verbal Gjobe me nr. serial, 0187503 datë 12.10.2015, ku në bazë të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Neni 122 pika 1, germa d , subjekti është penalizuar me gjobe në masën 20.000 (njetzet mijë) leke për mos afishim të posterit informues për tërheqjen e kuponit tatimor.

Sa me sipër, mos afishimi i posterit informues për tërheqjen e kuponit tatimor. , përben shkelje tatimore administrative dhe penalizohet me gjobe në zbatim të Neni 122 pika 1, germa d, të Ligjit 9920 dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar), sipas të cilit citojmë; "1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, denohet në rast se: d) nuk afishon në një vend të dukshëm një poster, që tregon detyrimin e bleresit të mallrave apo të përfituesit të shërbimit, për të kërkuar kupon tatimor, me gjobe në masën 20 000 (njetzet mijë) leke;"

**Së pesti:** Akt konstatimi i mbajtur nga ana e inspektoreve, është percjell për zbatim të metejshëm në DRT Vlorë. Inspektori i dosjes ka bërë verifikim në sistemin e deklarimit CAT@S dhe ka rezultuar se punonjësit Z. Bilbil Fejzaj dhe Znj. Sonila Dredha nuk janë deklaruar si punonjes nga tatimpaguesi në organin tatimor.

Në bazë të akt konstatimit të mbajtur është mbajtur dhe Proces-Verbal Gjobe me nr. serial, 0187504 datë 12.10.2015, ku në bazë të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar) neni 119, pika 1 germa (b), subjekti është penalizuar me gjobe në masën  $2 \times 50.000 = 100.000$  (njetqind mijë) leke për mosdeklarim punonjesi në organin tatimore perkatesisht Z. Bilbil Fejzaj dhe Znj. Sonila Dredha.

Pala paditese pretendon se nuk njihet me shtetasit e gjendur në aktivitetin e saj gjatë kontrollit tatimor, por në akt konstatimin e mbajtur nga inspektorët e tatimeve nuk është evidentuar ky fakt. Në akt është cituar se në momentin e kontrollit në punë u gjetën dy punonjes perkatesisht shtetasit Z. Bilbil Fejzaj dhe Znj. Sonila Dredha. Akti është percjell për procedurë të metejshme në DRT



Vlore, jane bere verifikimet e nevojshme ne sistemin CAT@s dhe rezultuan se keta dy punonjes jane te pa deklaruar ne organin tatimor.

Sa me siper, mund te themi se mosdeklarimi i punonjesit ne organin tatimor, perben shkelje tatimore administrative dhe penalizohet sipas Ligjit 9920 date 19/05/2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH" (i ndryshuar), perkatesisht neni 119 "*Mosdeklarim i punonjesve*" ku eshte percaktuar se subjekti duhet qe te deklaroje punonjesit qe fillojne pune per here te pare ne subjekt apo te punesuar rishtazi prane tij, te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes si dhe duke ju referuar ligjit nr. 9136 date 11.09.2003 "*Per mbledhjene e Detyrueshme te Kontributeve te Sigurimeve Shogore dhe Shendetesore*" Neni 11 pika 3 dhe Udhezimi nr. 23 te Ministrise se Financave ne zbatim te ketij ligji, pika 4.1 Tatimpaguesit persona juridike dhe fizike jane te detyruar te deklarojne ne forme elektronike ne administraten tatimore te punesuarit (perfshire dhe punonjesit e papaguar te familjes se personit fizik me te cilet ai punon e bashkejeton ligjerisht), qe fillojne pune per here te pare apo te punesuar rishtazi prane tij. Ky deklarim me te dhenat e kerkuara per secilin punonjes behet te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes se te punesuarve te rinj apo rishtazi.

Sa me siper, rezulton se kontrolli tatimor ka qene verifikim ne vend. Ne zbatim te Ligjit 9920 date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar, neni 80 Kontrolli tatimor dhe Udhezimit ne zbatim te ketij ligji, pika 80.3 (c) eshte percaktuar se: "*Keto verifikime te shkurtra synojne zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me regjistrimin e personave te tatueshem (identifikimin e personave te paregjistruar), me perdorimin e pajisjeve fiskale, me perdorimin e pullave fiskale ne mallrat e akcizes, me dokumentimin e mallrave ne ruajtje, perdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe leshimin faturave tatimore, etj.*

Keto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak te personave te tatueshem, por vetem nepermjet prezantimit ne momentin e verifikimit, te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdhrin e dites, te leshuar nga drejtuesi i drejtorise se kontrollit per verifikime ne vend". Kontrolli eshte ushtruar ne baze Urdher Sherbimit me Nr 61156 Prot. Dt. 17.09.2015 dhe Akt-Konstatimi me nr. serial 0564281 date 17.09.2015.

Bazuar ne piken 5, neni 108 te Ligjit 9920 date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne RSH" i ndryshuar dhe piken 108.5 te Udhezimit ne zbatim te tij, thuhet se: "*Ne proceduren e ankimit, barra e proves pgr te vertetuar se nje vleresim tatimor apo vendim eshte i pasakte bie mbi tatimpaguesin*".

Duke ju referuar te gjithave fakteve te mesiperme kerkojme rrezimin e kerkese padise dhe lenien ne fuqi te aktit administrativ "Njoftim Vleresimi per detyrimet date 14.10.2015" per vleren e gjobave ne shumen 255.000 (dyqind e pesedhete e pese mije) leke te DRT Vlore, si akte te mbeshtetura plotesisht ne ligj dhe konform te gjitha procedurave tatimore.

Për sa më sipër pala e paditur **Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë** kërkoi nga gjykata rrëzimin e kërkesë padisë si e pa bazuar në ligj dhe në prova.

**Pala pjesëmarrëse në gjykim Avokatura Shtetit Zyra Vendore Vlorë**

nuk u dëgjua në këtë gjykim dhe nuk ka depozituar prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate në lidhje me këtë gjykim, pasi ishte në mungesë me gjithë njoftimin e rregullt që ka pasur për procesin gjyqësor.

**Gjykata pasi kreu një hetim të plotë dhe të gjithëanshëm çmon se kërkesë padia duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova.**

#### **Arsyetimi ligjor:**

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ku parashikohet se "Të drejtën e padisë e ka:

a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Në nenin 17 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative" parashikohet se "Padia ngrihet":

c) për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;

Rezulton se pala paditëse subjekti person fizik "Antuela Pashaj" ka një interes legjitim për të kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore datë 14.10.2015 nxjerrë nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, pasi akti administrativ është nxjerrë në kundërshtim flagrant me ligjin.

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga ligji me nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ne nenin 80 të këtij udhezimi parashikohet kontrolli tatimor ku në piken 80.3/b të tij përcaktohet se kur mund të kryhen verifikimet në vend dhe konkretisht parashikohet se *'verifikimet në vend synojnë zbulimin e shpejta të shkeljeve që kanë lidhje me rregjistrimin e personave të tatueshëm, identifikimin e personave të parregjistruar, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin e faturave tatimore etj.*

Procedurat teknike të detajuara për kryerjen e një kontrolli tatimor përcaktohen në Manualin e kontrollit tatimor.

Në piken 83 të Udhezimit parashikohet se çfare duhet të përmbajë një raport kontroll dhe konkretisht "83.1 Pas çdo kontrolli tatimor, jo më shumë se shtatë ditë nga përfundimi i tij, inspektori i kontrollit tatimor, është i detyruar të përgatisë raportin e kontrollit. **83.2 Raporti i kontrollit tatimor, përshkruan veprimtarinë ekonomike e tregtare të personit të tatueshëm, deklaratat, dokumentet, librat, regjistrat dhe regjistrimet e kontrolluara, të dhënat e shfrytëzuara gjatë kontrollit dhe burimet e tyre, mënyrat e ushtrimit të kontrollit, etj. Raporti i kontrollit jep gjetjet e tij, problemet e dala, rezultatet e kontrollit, shkeljet e kryera nga personi i tatueshëm me argumentimin përkatës, shumën e vlerësimit tatimor të propozuar dhe referencat ligjore ku e mbështet atë. Raporti i kontrollit përbën bazën për vlerësimin tatimor pas kontrollit, për kontrole të mëvonshme si dhe për vlerësimin e punës së vete kontrollorit nga ana e drejtuesve të**

drejtorisë rajonale te tatimeve. 83.3 Inspektori i kontrollit i jep urdhëruesit te kontrollit një kopje e raportit të kontrollit, kurse një kopje tjetër ia dërgon personit te tatueshëm, me shërbimin postar rekomande.

83.4 Personi i tatueshëm i kontrolluar ka të drejtë të kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi.

83.5 Kundërshtimi paraqitet me shkrim dhe ai i dërgohet drejtorisë rajonale te tatimeve me shërbimin postar rekomande ose dorëzohet dorazi në drejtorinë rajonale përkundrejt marrjes së një konfirmimi me shkrim. 83.6 Inspektori/inspektoret e kontrollit tatimor, në bashkëpunim me eprorin direkt, brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes se kundërshtimit te personit te tatueshëm, shqyrtojnë kundërshtimin e paraqitur dhe japin gjykimin e tyre për te, gjykim te cilin e përfshijnë ne projektin e raportit përfundimtar te kontrollit tatimor. Për shembull, ne qofte se raporti i kontrollit tatimor është marre nga ana e personit te tatueshëm nëpërmjet shërbimit postar rekomande ne datën 5 te një muaji, personi i tatueshëm deri me date 10 te muajit duhet te dërgojë kundërshtimin e tij, nëpërmjet shërbimit postar rekomande, ne adresën e drejtorisë rajonale te tatimeve. Duke supozuar qe drejtoria rajonale e tatimeve e ka marre kundërshtimin ne datën 15 te muajit, inspektori/inspektoret e kontrollit do te kenë 5 dite pune kohe për te shqyrtuar kundërshtimin e personit te tatueshëm, për te dhënë gjykimin e tyre për kundërshtimin dhe se fundi për ta përfshirë kete gjykim ne projektin e raportit përfundimtar te kontrollit.

Nuk rezulton qe akt-kontrolli i dates 17.09.2015 te kete pershkuar deklaratat, dokumentet, librat, regjistrat dhe regjistrimet e kontrolluara, te dhënat e shfrytëzuara gjate kontrollit dhe burimet e tyre, mënyrat e ushtrimit te kontrollit, etj. Raporti i kontrollit jep gjetjet e tij, problemet e dala, rezultatet e kontrollit, shkeljet e kryera nga personi i tatueshëm me argumentimin perkates, shumën e vlerësimit tatimor te propozuar dhe referencat ligjore ku e mbështet atë. Raporti i kontrollit përbën bazën për vlerësimin tatimor pas kontrollit, për kontrole te mëvonshme si dhe për vlerësimin e punës se vete kontrollorit nga ana e drejtuesve te drejtorisë rajonale te tatimeve.

Pra nuk rezulton qe inspektoret tatimore te Drejtorise Rajonale Tatimore Vlore te kene pershkuar se çfare po kryente paditesja ne momentin e kontrollit, nese kete aktivitet po e kryente paditesja apo ndonje person tjetër fizik, pasi provohet se paditesja ka aplikuar per çrregjistrimin e aktivitetit prej muajit 02 qershor 2015 vertetuar nga vertetimi kryerjes se aplikimit ne QKR dhe gjithashtu dhe nga deklarata noteriale e pronarit te objektit rezulton se paditesja e ka pasur objektin ku ushtronte aktivitetin me qera deri ne daten 02 qershor 2015.

Pra nuk rezulton qe grupi i kontrollit te kete respektuar proceduren e kerkuar nga ligji dhe per kete arsye akt-kontrolli i dates 17.09.2015 i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Vlore eshte absolutisht i pavlefshem.

Po kështu dhe njoftim vlerësimi datë 14.10.2015 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm pasi ka dale mbi një akt-kontroll absolutisht të pavlefshëm.

Në rastin konkret gjykata çmon se mbajtja e proces-verbalit nga pala e paditur pa mundur të identifikoj shtetasit që kanë qenë duke punuar si dhe subjektin që i ka punësuar përbën shkelje flagrante të ligjit duke mbajtur parasysh se nga paditësja është aplikuar për çregjistrimin e saj si subjekt tatimor dhe ku për këtë qëllim pala e paditur ka detyrimin që të identifikoj sakt identitetin e shtetasve ndaj të cilit ushtron kontrollin, ku referuar akt konstatimit vetë pala e paditur pranon faktin se shtetasit Sonila Dredha dhe Bilbil Fejzaj nuk kanë kartë identiteti dhe ku në subjekti që është kontrolluar nuk është kërkuar dokumentë identifikimi NUIS i subjektin person fizik "Antuela Pashaj".

Pala paditëse person fizik "Antuela Pashaj" nuk mund të ngarkohet në mënyrë arbitrare me detyrim dhe ku është detyrë e palës së paditur për të verifikuar dhe identifikuar subjektet në mënyrë që mos të ngarkohet me detyrim në kundërshtim me ligjin subjektet tatimore.

Provohet dhe nga deklaratat noteriale shtetasit Nikolin Murataj se dyqanin e ndodhur në lagje 'Deshmoret' Rruga 'Lef sallata; kati I Pare Vlorë e ka dhënë me qira shtetasit Antuela Pashaj prej muajit janar 2014 deri në datën 02.06.2015, e cila ka ushtruar aktivitetin 'fast food'.

Në nenin 116 të K.Pr.Administrative sipas të cilit '*Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme në kuptimin e këtij Kodi në rastet e mëposhtme;*

a)kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;

b)kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;

**c)akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.**

Sa më sipër, gjykata çmon se "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore me datë 14.10.2015 i marrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë është një akt absolutisht i pavlefshëm" i nxjerrë mbi bazë e një akti absolutisht të pavlefshëm, akt konstatimin me nr.0564281 serie datë 17.09.2015 i mbajtur nga inspektorët e palës së paditur të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë dhe në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar) dhe akteve nën ligjore të nxjerrë në zbatim të tij.

Në rastin objekt gjykimi akti që kundërshtohet ka një vlerë 255.000 (dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, e cila është më e vogël se njëzet fishi i pagës minimale në shkallë vendi dhe ku për rrjedhojë duke patur parasysh se e drejta e ankimit rregullohet me ligj në zbatim neni 45 i ligjit me nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" kundër këtij vendimi nuk parashikohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Sa më sipër gjykata vendos pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

Në zbatim të nenit 106 të K.Pr.Civile, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit me nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

## V E N D O S I

Pranimin e kërkesë padisë.

Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet datë 14.10.2015" nxjerre për paditësen subjektin person fizik Antuela Pashaj, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Kundër këtij vendimi nuk parashikohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

U shpall në Vlorë, sot më datë 25.04.2016

**SEKRETARE**

Edlira SHEHU

**GJYQTARE**

Gentiana XHELILI

**SHPENZIMET GJYQËSORE**

Taksa e rregjistrimit

TOTALI

3.000 (tre mijë) lekë.

3.000 (tre mijë) lekë.

25.04 6

